

Përfshihu

“Ata gjetën një vend ku duhej të merrja klientët. Mu tha sa shumë klientëve duhet tu shërbeja në ditë, si dhe çmimet. Isha mbyllur aty dhe më torturonin. Nuk do t’i fal ata kurrë për këtë.” **Një e mbijetuar.**

“Nuk varet vetëm nga program ynë. Në shumicën e rasteve, shohim se integrim i suksesshëm do të thotë që komuniteti dëshiron t’i pranojë këta njerëz. Komuniteti thotë: “Po, Këta janë qytetarët tanë dhe ne duam që ata të kenë një jetë normale. Ajo nuk është diçka e pavlerë për shoqërinë” **Një menaxhere projekti.**

“Ndonjëherë trafikimi është i organizuar sepse një burrë apo një grua nga komuniteti i tyre merr 5 deri 10 fëmijë dhe del me ta që të punojë në rrugë.” **Një punonjës social.**

“ Shumica e njerëzve as nuk e dinë që njerëzit që lypin në rrugë apo vjedhin nëpër dyqane mund të jenë dhe viktimat e trafikimit.” **Një polic.**



“Unë ju falendëroj për dëshminë tuaj të sinqertë në Ungjillin e mëshirës, siç demonstrohet në përkushtimin tuaj për ripërtëritjen dhe rehabilitimin e viktimave të Trafikimit të Njerëzve.”

Fjalimi i Papa Franceskut në Asambleenë e Dytë Europiane të RENATE, 7 Nëntor 2016.



Detajet e Bankës:

Emri i Llogarisë: Fondacioni RENATE
Banka: ABN AMRO Bank,
Den Bosch, Hollandë
Numri i Llogarisë: 587386703
IBAN: NL31 ABNA 0587 3867 03
SWIFT (BIC): ABNANL2A

Donacionet në mbështetje të RENATE do të pranohen me mirënjohje.

www.renate-europe.net
E-mail: renatenetwork@gmail.com



Besimtarët në Europë të Bashkuar Kundër Trafikimit dhe Shfrytëzimit



Besimtarët në Europë të Bashkuar Kundër Trafikimit dhe Shfrytëzimit

RENATE është themeluar nga një grup Besimtarësh të cilët përfaqësojnë disa kongregacione të ndryshme që punojnë kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Europë.

Anëtarësia në RENATE është e hapur ndaj:

- një Besimtar femër / mashkull –që punon/jeton në Europë;
- një personi të thjeshtë i cili punon me apo për Besimtarët në fushën kundër trafikimit në Europë;

Miqtë e RENATE:

- Të gjithë janë të mirëpritur për të mbështetur në mënyra të ndryshme: financiarisht, me aftësi dhe ekspertizë, lutje, etj;
- Ata vijnë nga të gjitha traditat e Besimit apo asnjë prej tyre;
- Do të marrin përditësime dhe buletine;

Ne ju ftojmë të gjithë të bashkoheni me ne, në këtë Mision të Zotit.

Dhënia fund e Trafikimit Fillon me NE.

Vizioni

Të gjithë njerëzit janë krijuar në imazhin e Zotit. Ne, Besimtarët e Europës, besojmë në një botë ku çdokush ka të drejtën e dinjitetit njerëzor. Dinjiteti njerëzor nuk mund të kompromentohet. Prandaj punojmë që të çlirojmë botën nga trafikimi dhe shfrytëzimi.

Qëllimi

Të përgjigjemi në dritën e vlerave të Ungjillit ndaj çështjes së trafikimit të grave, fëmijëve dhe burrave.

Objektivat

- Të zhvillojmë ndërgjegjen – zhvillimi i veprimtarive kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kërkesës në rritje në të gjitha nivelet e shoqërisë në Europë, duke përdorur të gjitha format e teknologjisë modern dhe komunikimit;
- Rrjetëzimi dhe ndarja e burimeve, aftësive dhe njohurive;
- Të hulumtojmë dhe zbatojmë plane veprimi kundër kërkesës në rritje për abuzime të tilla në shtete të origjinës dhe destinacionit.



Rrjeti RENATE: Duke ndertuar ura përgjatë gjithë Europës.

Së bashku me Kishën, Shtetin dhe Shoqërinë Civile, në harmoni me përmbushjen e Objektivave të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, Rrjeti RENATE është i përkushtuar që të:

- Punojë pa u lodhur për rehabilitimin e viktimave, të çlirojë botën nga shfrytëzimi seksual dhe për punë, skllavëria dhe heqja e detyruar e organeve.
- Të trajtojë shkaqet bazike të padrejtësisë sistemike që krijojnë dhe mbajnë gjallë këtë tregti të ndyrë të jetëve njerëzore.
- Të përdorë rrjetin e tij për të forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit.
- Të ofrojë mundësi për ri-integrimin e plotë të viktimave, të cilat mund të përfshijnë mbrojtjen në një strehë të sigurtë, sigurimin e dokumenteve të nevojshme dhe trajnimeve për një punë të denjë në mënyrë që viktimat të mund të rifitojnë dhe të kenë mundësi që të jetojnë plotësisht jetën.
- Të edukojë shoqërinë, sidomos të rinjtë që të konsiderojnë të gjitha format e trafikimit të njerëzve dhe shfrytëzimit si totalisht të papranueshme.
- Të sfidojë autoritete gjyqësore dhe civile që të miratojnë dhe venë në zbatim ligje që mbrojnë viktimat, u sigurojnë atyre kompensim të mjaftueshëm, ndëshkojnë klientët dhe blerësit dhe konfiskojnë asetet e kriminelëve.
- Të bashkëpunojë me median në përpjekje për të sjellë një zë të fuqishëm në vëmendjen e botës për të denoncuar të gjitha aspektet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit.